




Njësia Bashkiake Nr. 8,  
Rruga "Shinasi Dishnica",  
Pall. 70, Kati 2, Zyra Nr. 2,  
Tirana, Albania  
Tel/Fax: +355 42 252 888  
www.arb.al



Datë: e martë, 2021-10-12

Nr. 131612 Ora 11:27  
Prot.  
Dosja Nr. 612

## VENDIM Për Pushimin e "Urdhrit të Ekzekutimit" të ekzekutuar tërësisht

**Drejtuar:** 12 Bankave të Nivelit të Dytë

**Drejtuar:** **Qendrës Kombëtare të Biznesit**, me adresë në: Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona Nr. 33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë;

**Për dijeni Debitorit:** Shoqërisë "**ALBAWINE&COO**" Sh.p.k., me NIPT **L81319031Q**, dhe adresë në: Autostrada Tiranë - Durrës, Kilometri 13, Rruga "Bashkia", pranë Supermarket "Sallaku", Vorë, Tiranë; me Përfaqësuesi Ligjor **Z. Luan Sallaku**;

**Për dijeni Kreditorit:** Shoqërisë "**STAR 2000**" Sh.p.k., me NIPT **K01510003J**, me adresë në: Autostrada "Tiranë - Durrës", Km. 2, Rruga dytësore, Tiranë; përfaqësuar nga Përfaqësuesi Ligjor **Znj. Aneta Gjika**.

Unë, **Alban Ruli**, përmbarues gjyqësor privat pranë zyrës së përbarimit privat **ARB (ARB)** pasi studiova materialet e dosjes përbarimore Nr. **612**, bazuar në Urdhrit e Ekzekutimit Nr. **3348** Regj. Them., datë **24.06.2020**, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,

### KONSTATOVA:

Se më datë 03.07.2020 është depozituar pranë **ARB** kërkesa e kreditorit "**STAR 2000**" Sh.p.k., së bashku me:

- Urdhrit e Ekzekutimit Nr. **3348** Regj. Them., datë **24.06.2020**, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili vendosi:
  - "Pranimin e kërkesës.
  - Lëshimin e urdhrit të ekzekutimit në favor të palës kreditore shoqërisë "**STAR 2000**" shpk, me NUIS **K01510003J**, me seli në Autostrada Tiranë- Durrës, km 2, (Dytësor), Tiranë; që shpreh detyrimin e debitorit shoqërisë shoqërisë **AlbaWine&Coo** shpk, me NUIS **L81319031Q**, me seli Autostrada Tiranë- Durrës, km 13, rruga "Bshkia", Vorë, pranë suëprmarketit "Sallaku", Vorë, Tiranë, për faturat tatimore të shitjes:
    - faturën tatimore shitje, me nr.serie 63015304, nr. 5304, date 13.09.2019, ne vleren 265,000 (dyqindegjashtëdhjetëepesë mijë) leke;
    - faturen tatimore të shitjes me me nr.serie 63015306, nr. 5306, date 16.09.2018, ne vleren 265,000 (dyqindegjashtëdhjetëepesë mijë) leke; si dhe kamatat ligjore mbi këto shumat të llogaritura sipas nenit 5 te ligjit nr 48/2014 "Per pagesat e vonuara ne detyrimet kontraktore e tregtare.
    - Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës kërkuese.
    - Ngarkohet Shërbimi Permbarimor të bëjë ekzekutimin e titullit ekzekutiv.
    - Ky vendim hartohet vetëm në një kopje.
    - Kundër këtij vendimi, sipas ligjit, nuk lejohet ankim.
    - U shpall sot, në Tiranë më datë 24.06.2020."



Nga studimi i dokumenteve të dosjes përbarimore rezultoi se, pas kalimit të afatit 10 (dhjetë) ditor të ekzekutimit vullnetar dhe nga pala debitore shoqëria “ALBAWINE&COO” Sh.p.k., me NIPT **L81319031Q**, nuk kishte shuma të ardhura në llogarinë përbarimore të ARB dhe në këto kushte ARB filloj ekzekutimin e detyrueshëm dhe u kryen sekuestrimet/kalimet e shumave sipas transfertës datë 10.08.2020 dhe datë 11.10.2021. Më datë 12.10.2021, ARB ka kaluar shumën e mbetur në llogaritë bankare të kreditorit STAR 2000, me përshkrimin: - “Sa kaluar pagesë që përbën ekzekutimin tërësor të urdhrin të ekzekutimit Nr. 3348 Regj. Them., datë 24.06.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.” Në këto kushte detyrimi sipas Urdhrit të Ekzekutimit Nr. **3348** Regj. Them., datë **24.06.2020**, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është shlyer tërësisht nga pala debitore.

Sa më sipër, në mbështetje të nenit **616** pika “a”, dhe nenit **617** të Kodit të Procedurës Civile, dhe Ligjit Nr. **26/2019**, datë 08.05.2019 “Për Shërbimin Përbarimor Gjyqësor Privat”,

#### VENDOSA:

1. Pushimin e ekzekutimit të Urdhrit të Ekzekutimit Nr. **3348** Regj. Them., datë **24.06.2020**, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, **si tërësisht të ekzekutuar**.
2. **12 bankat e nivelit të dytë** të bëjë heqjen e bllokimit të llogarive bankare të debitorit, të vendosur me Urdhrin për Vënien e Sekuestros Konservative, Nr. **12/612** Prot., datë **01.09.2021**, të **ARB**.
3. **QKB** të bëjë heqjen e sekuestros konservative, të vendosur me Urdhrin për Vënien e Sekuestros Konservative, Nr. **3/612** Prot., datë **27.07.2020**, të **ARB**.
4. Ky vendim mbahet në disa kopje, ku njëra qëndron në dosjen përbarimore, dhe të tjerat iu komunikohen palëve të interesuara.
5. Palët e interesuara kanë të drejtën e ankimit në gjykatën ku ekzekutohet titulli ekzekutiv brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja dijeni.
6. Dosja përbarimore do të arkivohet, duke u bërë veprimet përkatëse.

Zyra e Përbarimit Privat ARB  
Përbaruesi Gjyqësor Privat

